



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:032144  
Datë: 01.03.2019  
Numri i dokumentit: 00236755

**P.nr.1010/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.P, nga Prizreni dhe B.M, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP/II.nr.988-7/18 të datës 27.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Fatos Ajvazi, dhe të akuzuarve, me datë 14.01.2019, publikisht morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**1.A.P**, nga i ati N. dhe nëna S. e lindur N., ka të kryer shkollën fillore, punëtor ndërtimtarie, i martuar, baba i ... fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**2.B.M**, nga i ati H. dhe nëna F. e lindur B., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, baba i ...fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**J A N Ë F A J T O R**

**I akuzuari A.P.**

**I.**Me datë 05.04.2018, rreth orës 18,00 në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, saktësisht afër market “...i ri”, i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit B.M, në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të ditës kritike deri sa i dëmtuari ishte duke kaluar rrugën, i

pandehuri ndalon, dhe në momentin kur i dëmtuari i drejtohet me fjalët “çka të pata borgj gji ke tem shkel” i pandehuri fillon ta shajë me fjalët “A ta q... n... se po ecis kadalës”, dhe fillon ta godet me grushta në fytyrë, me ç’ rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KP-ës.

### **I akuzuari B.M:**

2.Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I të aktvendimit për fillimin e hetimeve, në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, saktësisht afër market “...i i ri”, i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit A.P, në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të ditës kritike deri sa i dëmtuari ishte duke drejtuar automjetin e tij, për një moment i pandehuri, i del para automjetit dhe në momentin kur i dëmtuari ndalon automjetin i pandehuri fillon ta godet me grushta në kokë, me ç’ rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KP-ës,

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 188 par.1 të KP-së, të akuzuarve ju shqipton:

### **Të akuzuarit të parë A.P:**

#### **DËNIM ME KUSHT**

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale

### **Të akuzuarit të dytë B.M:**

#### **DËNIM ME KUSHT**

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse e akuzuari nuk kryen vepër të re penale

Obligohen të akuzuarit të paguajnë në mënyrë solidarë shpenzimet e procedurës penale dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00 euro dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

#### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.988-7/18 të datës 27.06.2018, kundër të akuzuarve A.P, nga Prizreni dhe B.M, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj pranë aktakuzës PP/II.nr.988-7/18 të datës 27.06.2018, kundër të akuzuarve A.P, nga Prizreni dhe

B.M, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KP-ës, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu të akuzuarit në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për veprat penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat ju vihen në barë

I akuzuari i parë A.P, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, e tërë ngjarja ka ndodhur ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, si në kohë, vende dhe mënyrë, për ndryshe me të dëmtuarin B.M jemi edhe miq familjar, pas rastit të ndodhur ne jemi në raportet të shëndosha që nga ajo ditë e deri më sot, e tëra që ka ndodhur ka qenë një moment i qasjes, pendothem thellë për kryerjen e kësaj vepre, pendothem thellë për veprimet e kryera, andaj i propozoj gjykatës që të cekurat më lart ti merr për bazë si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, e po ashtu edhe rrethanat e mija personale që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, e po ashtu edhe rrethanat e mija familjare që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, dhe me punën time nga të ardhurat që i siguroj si punëtor ndërtimtarie, janë burim i vetëm i ekzistencës e familjes sime.

I akuzuari i dytë B.M, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale e cila më vihet në barë, e tërë ngjarja ka ndodhur ashtu siç është përshkruar në kohë, vend dhe mënyrë si në dispozitiv të aktakuzës, më vije keq për veprën e kryer, pendothem thellë për veprimet e kryera, andaj i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, si dhe raportet tona në mes vete që jemi miq, si dhe faktin që nga koha e kësaj ngjarje e deri më sot më nuk kemi pasur mosmarrëveshje apo probleme, dhe shoqëria jonë vazhdon të jetë ajo që ka qenë, e tëra që ka ndodhur ka qenë një moment i veprimit të momentit, andaj të gjitha të cekurat më lart, si dhe rrethanat e mija personale, që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, e po ashtu edhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, si dhe rrethanat e mija familjare, që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, si dhe me punën time të punëtorit e siguroj ekzistencën e familjes sime, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

### **I akuzuari A.P.**

I.Me datë 05.04.2018, rreth orës 18,00 në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, saktësisht afër market "...i i ri", i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit B.M, në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të ditës kritike deri sa i dëmtuari ishte duke kaluar rrugën, i pandehuri ndalon, dhe në momentin kur i dëmtuari i drejtohet me fjalët "çka të pata borgj gji ke tem shkel" i pandehuri fillon ta shajë me fjalët "A ta q... n... se po ecis kadalës", dhe fillon ta godet me grushta në fytyrë, me ç' rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore,

### **I akuzuari B.M:**

2.Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I të aktvendimit për fillimin e hetimeve, në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, saktësisht afër market "...i i ri", i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit A.P, nëë atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të ditës kritike deri sa i dëmtuari ishte duke drejtuar automjetin e tij, për një moment i pandehuri, i del para automjetit dhe në momentin kur i dëmtuari ndalon automjetin i pandehuri fillon ta godet me grushta në kokë, me ç' rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale e cila ju vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ju shqiptoi dënimin me kusht paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, sjellja korrekte e tyre pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tyre, gjer më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarve, moshën e të akuzuarve, i akuzuari i parë është person familjar, baba i tre fëmijëve, si dhe i akuzuari i dytë është person familjar, baba i tre fëmijëve, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarve me gjykatën, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, shprehja e keqardhjes të akuzuarve për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata ju shqiptoi veç e veç dënimet dhe ate të akuzuarit të pare A.P dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, të akuzuarit të dytë B.M i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe shpenzimet mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1010/2018 me datë 14.01.2019**

**Procesmbajtësja**  
**Nacis Sarani**

**Gjyqtari,**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.